

KONTRATË PËR SHITBLERJE E KUOTASH

Lidhur ndërmjet palëve:

- Z. **Bledar Hitaj**, shtetas shqiptar, i datelindjes 17.05.1980, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me nr Personal: I00517093L, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, në vijim "**Shitësi**";

dhe:

- Z. **Emiljan Duka**, shtetas shqiptar i datelindjes 06.01.1992, lindur dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit Pasaporte me nr Personal: J20106044M, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, në vijim "**Blerësi**".

DUKE QENË SE:

- A.** Shitësi është pronar i një kuote pjesëmarrjeje të barabartë me 100% të kapitalit themeltar, të shoqërisë "Infolab" sh.p.k, shoqëri e së drejtës shqiptare, me seli Tirane Kashar YZBERISH Lagjja Yzberish, rruga "Eqerem Çabej", nd.21, h.2, ap.11, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me kod identifikues tatimor (NUIS) Nr. L82417007P ("**Shoqëria**").
- B.** Shitësi ka rënë dakord t'i shesë Blerësit dhe Blerësi është dakord të blejë nga Shitësi kuotën që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë ("**Kuota**"), kundrejt çmimit dhe në kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë.


PËR SA MË SIPËR:

Në konsideratë të parashtrimeve të mësipërme, palët bien dakord si vijon.

1. Kalimi i kuotës

Me lidhjen e kësaj kontrate, Shitësi i shet dhe i kalon Blerësit, dhe Blerësi blen Kuotën, të lirë nga pengje, kufizime, detyrime ose pretendime të çfarëdo lloji dhe natyre, kundrejt çmimit total prej 100.000 (njeqind mij) Lek. Ky çmim është paguar nga Blerësi në favor të Shitësit në mënyrat e konkorduara ndërmjet palëve.

2. Deklaratat dhe garancitë e Shitësit



2.1. Shitësi deklaron se është pronari i vetëm ligjor dhe se disponon lirisht Kuotën objekt i kësaj kontrate.

2.2. Kuota është shlyer tërësisht dhe nuk është objekt i ndonjë pengu, barre, privilegji, kufizimi, detyrimi ose të drejte tjetër të çfarëdo lloji në përfitim të të tretëve.

2.3. Shitësi deklaron se Kuota është lirisht e transferueshme.

3. Legjislacioni i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

4. Dispozita të përgjithshme

4.1. Të gjitha shpenzimet dhe kostot që lidhen me këtë kontratë janë në ngarkim të Blerësit.

4.2. Kjo kontratë zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme mes palëve.

4.3. Palët marrin përsipër të nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo akt, kontratë, dokument ose deklaratë tjetër, që mund të jetë e nevojshme ose e përshtatshme për zbatimin e plotë dhe të saktë të regjistrimit të kalimit të Kuotës nga Shitësi te Blerësi.


4.4. Palët pranojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale, sipas legjislacionit shqiptar; këto të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave apo në arkivat informatikë vetëm për qëllime që lidhen me këtë kontratë, apo me formalitetet dhe efektet tatimore që lidhen me të.

Kjo kontratë hartohet në 3 kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Nënshkruar, më datë 24.03.2021

SHITËSI

BLEDAR HITAJ

Bledar Hitaj


BLERËSI

EMILJAN DUKA

Emiljan Duka
